

## K R E U IV

# LUFTA E PARTISË PËR SHNDËRRIMIN E SHQIPËRISË NGA NJË VEND BUJQËSOR I PRAPAMBETUR NË NJË VEND BUJQËSOR-INDUSTRIAL

(1948-1955)

### 1. KONGRESI I I PKSH — KTHESË HISTORIKE NË JETËN E PARTISË DHE TË VENDIT

Kongresi I i PKSH zhvilloi punimet në Tiranë më 8-22 nëntor 1948. Në të morën pjesë 563 delegatë me votë deliberative dhe 299 delegatë me votë konsultative, që përfaqësonin 29 137 anëtarë dhe 16 245 kandidatë partie.

Raportin mbi punën e Komitetit Qendror e mbajti Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Enver Hoxha. Në këtë raport ai analizoi gjithë veprimtarinë e Partisë që nga krijimi i saj. Njëkohësisht parashitroi politikën e Partisë për periudhën e ardhshme. Fryma e partishmërisë proletare që e përshkonte raportin dhe qëndrimi parimor marksist-leninist ndaj problemeve themelore orientuan drejt delegatët e Kongresit dhe përcaktuan mbarëvajtjen e punimeve të tij.

#### **Demaskimi dhe dënimi i revizionistëve jugosllavë**

të praktikave antimarksiste të revizionistëve jugosllavë, për arsye se, siç vihet në dukje në Rezolucionin e tij, të gjitha gabimet e rënda të vërtetuara në jetën e Partisë e kanë pasur burimin kryesisht në «presionin e në ndërhyrjen e jashtë-

Kongresi u ndal në mënyrë të veçantë në demaskimin e dënimin e pikëpamjeve dhe

ligjshme të udhëheqjes trockiste jugosllave». Pa demaskuar e pa dënuar qëndrimet e veprimet antimarksiste dhe antishqip-tare të tyre nuk mund të çohet deri në fund e të realizohej plotësisht kthesa e filluar në Plenumin e 11-të të KQ.

PKSH shikonte se shumë qëndrime të udhëheqjes jugo-sllave pas Çlirimit s'përputheshin me teorinë marksiste-leniniste dhe me socializmin shkencor, se në Jugosllavi nuk ecej në rrugën leniniste të ndërtimit socialist. Kur ajo u njoh me letrat e Stalinit, dërguar KQ të PKJ, krijoi bindje të plotë se atje nuk ndërtohej socializmi, por zhvillohej kapitalizmi.

Shteti jugosllav i pasluftës nuk ishte një diktaturë e pro-letariatit, por shtet i një klase të re borgjeze në aleancë me borgjezinë e vjetër jugosllave. Në këtë shtet qenë bërë të plot-fuqishme ushtria dhe ministria e brendshme me UDB, si në një diktaturë të tipit fashist.

Nën kontrollin e drejtpërdrejtë të ministrisë së brendshme e të UDB qe vënë edhe PKJ. Në të qenë shkelur të gjitha normat marksiste-leniniste të ndërtimit e të rolit udhëheqës të partisë proletare. Edhe partia qe shndërruar kështu në një organ shtetëror për të shtypur klasën punëtore dhe masat e tjera punonjëse.

Titistët, vuri në dukje Kongresi, qenë përpjekur me të gjitha forcat e mjetet për t'ia imponuar edhe Partisë Komuniste të Shqipërisë ideologjinë, politikën e metodat e tyre anti-marksiste. Për këtë qëllim, kishin organizuar, midis të tjerave, edhe grupin komplotist të Koçi Xoxes. Si rrjedhim, ata kishin ndikuar që në PKSH të hynin mjaft nga këto pikëpamje e prak-tika të tyre të huaja për marksizëm-leninizmin dhe socializ-min shkencor, sidomos në çështjet organizative, por në mjaft raste edhe në çështjet ekonomike e politike. Pasojë e këtij ndi-kimi ishte edhe qëndrimi i papërligjur i Partisë në gjysmle-galitet në vitet e para pas Çlirimit. Megjithatë presionet dhe ndërhyrja e revizionistëve jugosllavë s'kishin mundur të prek-nin politikën proletare të Partisë për luftën e klasave, politi-kën ekonomike dhe vijën politike revolucionare të saj në për-gjithësi.

Duke demaskuar e duke dënuar revizionistët jugosllavë, Kongresi çoi deri në fund edhe shkatërrimin e grupit tradhtar të Koçi Xoxes.

Gjatë punimit në organizatat e partisë të Rezolucionit të Plenumit të 11-të, u zbuluan shumë fakte e dokumente që

hidhnin dritë të plotë mbi veprimtarinë armiqësore të Koçi Xoxes, Pandi Kristos etj., që rëndonin më shumë fajet e tyre si shërbëtorë të udhëheqjes revizioniste jugosllave. Për këtë shkak, komunistët i gjykonin të lehta masat ndëshkimore që u kishte dhënë atyre Plenumi i 11-të i KQ dhe kërkuan të merreshin masa më të rënda, rrënjësore. Kongresi, duke shprehur vullnetin e gjithë komunistëve, i përjashtoi nga radhët e Partisë Koçi Xoxen e Pandi Kriston, për shkak se me anë të veprimtarisë së tyre armiqësore «në bashkëpunim të plotë dhe të koordinuar me grupin nacionalist-trockist të Titos dhe Rankoviçit u munduan të shkallmonin Partinë tonë, të zhduknin indipendencën e vendit tonë dhe të degjeneronin Republikën tonë Popullore në një koloni jugosllave e në një republikë borgjeze vasale të imperializmit. . . »<sup>1</sup>.

Në lidhje me qëndrimin ndaj Jugosllavisë, Kongresi u shpreh në mënyrë të vendosur për ruajtjen e miqësisë me popujt jugosllavë, të krijuar në luftën e përbashkët çlirimtare kundër pushtuesve fashistë, e për zhvillimin e një lufte të pajtueshme ideologjike e politike me grupin tradhtar revizionist të Titos<sup>2</sup>.

**Orientimet themelore për ndërtimin e bazave të socializmit** Duke shtruar nevojën për ta çuar deri në fund luftën kundër shtrembërimeve në vijën politike, të rrjedhura nga ndërhyrja armiqësore jugosllave, Kongresi përcaktoi orientimet themelore për ndërtimin e bazave të socializmit.

Si detyrë themelore ekonomike ishte nxjerrja e vendit nga prapambetja e madhe me anën e zhvillimit të vullshëm të forcave prodhuese.

Thelbin kryesor të kësaj detyre e përbënte industrializimi socialist dhe elektrifikimi i vendit. Domosdoshmëria e industrializimit diktohej nga nevoja për të krijuar një bazë materialo-tekhnike krejt të re në ekonominë popullore, për të zgjeruar prodhimin e mallrave në vend, për të përgatitur kushtet e riorga-

1 Rezolucion i Kongresit I të PKSH, Dokumente Kryesore të PPSH, vëll. I, f. 575.

2 Po aty, f. 563-564.

nizimit të bujqësisë mbi baza socialiste, për të rritur klasën punëtore në mënyrë që kjo të forconte pozitën e saj drejtuese. Industrializimi socialist do t'i shërbente drejtpërdrejt ruajtjes së fitoreve dhe zhvillimit të revolucionit, ndërtimit të shoqërisë socialiste.

Industrializimi socialist duhej të kryhej me ritme të shpejta në mënyrë që brenda një kohe sa më të shkurtër të kapërcehej prapambetja e trashëguar nga e kaluara, të sigurohej zhvillimi i ekonomisë në mënyrë të pavarur dhe të arrihej një ngritje e dukshme e nivelit material dhe kulturor të masave punonjëse. Plotësimi i kësaj detyre mbështetej në radhë të parë në shfrytëzimin sa më të plotë të pasurive të tokës e të nëntokës, duke përmirësuar e duke riorganizuar industrinë ekzistuese dhe duke ngritur një varg veprash dhe degësh të reja industriale.

Krahas industrializimit socialist, Kongresi i kushtoi rëndësi të madhe nxjerrjes së bujqësisë nga prapambetja dhe zhvillimit të saj. E vetmja rrugë për zgjidhjen e plotë të kësaj detyre ishte riorganizimi socialist i fshatit. Pasi u kritikuan gabimet që ishin bërë në çështjen e kolektivizimit, Kongresi e orientoi Partinë «nga përforcimi i sektorit socialist në bujqësi (fermat shtetërore) dhe nga kolektivizimi gradual, i matur dhe vullnetar i tokës në fshat me anën e kooperativave bujqësore të punës, duke i përkrahur shteti këto kooperativa politikisht, ekonomikisht dhe organizativisht. . .»<sup>1</sup>. Meqenëse ende nuk ishin pjekur kushtet për kolektivizimin e gjerë, veprimtaria e Partisë në këtë fushë do të udhëhiqej nga parulla «Në çështjen e kolektivizimit as të mos shpejtohem, as të mos ndalemi në vend».

Ekonomitë individuale që përbënin shumicën e bujqësisë ndodheshin në një shkallë të ulët zhvillimi, prandaj u pa e nevojshme t'i jepej një ndihmë e gjithanshme fshatarit punonjës individual në mënyrë që të shtoheshin prodhimet bujqësore.

Në të njëjtën kohë Kongresi kërkoi të mos harrohej për asnjë çast rreziku i zhvillimit të kapitalizmit në fshat në kushtet e mbizotërimit të ekonomisë individuale. Ai dha direktivën që të zbatoheshin politika e kufizimit ekonomik dhe e veçimit politik të elementëve kapitalistë të fshatit.

<sup>1</sup> Rezolucioni i Kongresit I të PKSH. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 565.

Në zbatimin e politikës së vet në fshat Partia do të orientohej nga parulla leniniste: «Mbështetje të fshatari i varfër, aleancë me fshatarin e mesëm, luftë kundër kulakut».

Zhvillimi i vendit në rrugën e socializmit kërkonte të vazhdohej lufta për zhdukjen e prapambetjes kulturore, për thellimin e revolucionit kulturor dhe ideologjik. Lidhur me këtë duhej të merreshin të gjitha masat për zbatimin e arsimit fillor të detyrueshëm, për zgjerimin e arsimit të mesëm, sidomos profesional, për krijimin e të gjitha kushteve të zhvillimit të arsimit të lartë, për përgatitjen e kuadrove të lartë brenda e jashtë vendit.

Pasi u kritikuan përpjekjet e revizionistëve jugosllavë e të grupit të Koçi Xoxes për të futur në fushën e arsimit, të artit e të kulturës frymën e mohimit të traditave dhe të vlerave kulturore të popullit shqiptar, Kongresi dha në këtë fushë orientimet kryesore që do të përbënin thelbin e zhvillimit të revolucionit kulturor. Arsimi e kultura duhej të bëheshin të popullit dhe t'u shërbenin masave të gjera punonjëse. Duke u mbështetur në vlerat kombëtare, të pajiseshin ato me një përmbajtje të thellë socialiste. Në arsim, art e kulturë Partia do të luftonte kundër ndikimit të ideologjisë borgjeze dhe do të mbështetej fort në shkencën marksiste-leniniste.

Kongresi shqyrtoi dhe pranoi direktivat e planit dyvjeçar të zhvillimit ekonomik e kulturor të vendit për vitet 1949-1950. Gjatë këtij plani do të përgatiteshin kushtet për të kaluar në zhvillimin e ekonomisë me plan me afate më të gjata.

Rëndësia kryesore në planin dyvjeçar iu kushtua zhvillimit të industrisë, për të cilën u caktuan rreth 47 për qind e gjithë investimeve të dyvjeçarit. Vendi e parë e zinte shtimi i prodhimeve minerare, në mënyrë të veçantë i naftës dhe i bitumit. Vendi e dytë e zinte zhvillimi i industrisë së lehtë. Gjatë dyvjeçarit parashikohej ndërtimi i kombinatit të tekstilëve në Tiranë, i fabrikës së sheqerit në Maliq, i hidrocentralit të Selitës dhe i një vargu veprash të tjera. Për kapërcimin e vështirësive në furnizimin e popullit me mallra industriale një rol të veçantë do të luante edhe zhvillimi e kooperimi i mëtejshëm i artizanatit.

Në fushën e bujqësisë parashikohej shtimi i prodhimeve bujqësore nëpërmjet zgjerimit të sipërfaqeve të mbjella, rritjes së rendimentit, zgjerimit të bonifikimit e të mekanikës bujqësore etj.

## **Forcimi dhe demokratizimi i mëtejshëm i pushtetit popullor**

Për ndërtimin e bazave të socializmit Kongresi theksoi domosdoshmërinë e forcimit dhe të demokratizimit të mëtejshëm të pushtetit, të forcimit të Ushtrisë Popullore dhe të Sigurimit të Shtetit.

Ndarja e pushtetit në këshilla rrethi dhe qyteti, kur të parat merreshin kryesisht me problemet e fshatit dhe të dytat kryesisht me problemet e qytetit, u quajt gabim parimor. Kjo masë administrative e huajtur nga revizionistët jugosllavë kishte shpënë në shkëputjen artificiale të punonjësve të qytetit e të fshatit. Për të zhdukur këtë të metë u dha udhëzim të shkriheshin menjëherë këshillat e rrethit me të qytetit në mënyrë që organet lokale të pushtetit të merreshin me të gjitha problemet e jetës ekonomike dhe politike të rrethit.

U kritikua dualizmi pushtet-parti dhe gjendja jo e rregullt e krijuar si pasojë e këtij dualizmi që kishte shkaktuar nënvleftësimin e dobësimin e rolit të organeve të pushtetit, shtimin e burokracisë dhe zvarritjen e zgjidhjes së çështjeve. Këshillat popullorë me komitetet ekzekutive duhej të përdornin të gjitha të drejtat që u jepte ligji, në mënyrë që të rritej roli i tyre.

Qëllimet e veprimtaria armiqësore e imperialistëve dhe e shërbëtorëve të tyre kundër RPSH, të rrethuar nga të gjitha anët prej shtetesh armiq, shtronin përpara Partisë e popullit detyrën e madhe të qëndronin vazhdimisht syhapur e të rritnin pa pushim fuqinë mbrojtëse të vendit.

Lidhur me këtë, Kongresi dha direktivën për forcimin e gjithanshëm të Ushtrisë Popullore, për rritjen e gatishmërisë luftarake të saj e të popullit. Ai orientoi që përgatitja luftarake e politike e ushtrisë të zhvillohej me programe të ndërhuara mbi bazën e ideologjisë e të shkencës ushtarake marksiste-leniniste, të përvojës së UNÇSH e të artit ushtarak stalinian në përshtatje me kushtet e vendit.

Një nga problemet më të vështira në këtë kohë ishte zhdukja e gabimeve në organet e Sigurimit të Shtetit, vënia e tyre në rrugë të drejtë dhe forcimi i mëtejshëm i këtyre organeve, të cilat në vitet e kaluara ishin prekur më shumë se çdo sektor tjetër nga ndërhyrja jugosllave dhe veprimtaria trockiste e Koçi Xoxes. Kongresi miratoi të gjitha masat që kishte marrë Partia pas Plenumit të 11-të të KQ për asgjësi-

min e metodave policore në organet e Sigurimit dhe për pastrimin e tyre nga njerëzit që kishin bërë faje të rënda. Në mënyrë të posaçme ai theksoi që veprimtaria e armës së Sigurimit të zhvillohej drejtpërdrejt nën udhëheqjen e kontrollin e Partisë dhe të mbrohej ligjshmëria socialiste.

Në të njëjtën kohë Kongresi porositi që analiza e gabimeve në Sigurimin e Shtetit të bëhej me frymë partishmërie. Ai kishte kryer shërbime të çmueshme për ruajtjen e fitoreve të revolucionit. Dënimi i gabimeve nuk duhej të drejtohej në asnjë mënyrë kundër domosdoshmërisë së tij e të mos shndërrohej në luftë kundër njerëzve të Sigurimit në përgjithësi. Ata që kishin gabuar do të ndihmoheshin nga Partia për të ndrequr gabimet. Kongresi paralajmëroi se armiku i klasës do të përpiqej të shfrytëzonte gjendjen për të dobësuar organet e Sigurimit, kurse «Partia do të punojë që arma e Sigurimit të Shtetit të forcohet sa më tepër, sepse ajo është arma e dashur e pushtetit që drejtohet nga Partia, që ruan Partinë dhe pushtetin nga puna armiqësore e armiqve të jashtëm dhe të brendshëm»<sup>1</sup>.

Në përputhje me politikën e saj të brendshme revolucionare Kongresi përcaktoi edhe një politikë të jashtme marksiste-leniniste, që rridhte nga vetë natyra e shtetit socialist dhe që u përgjigjej interesave të popullit e të atdheut. Kjo politikë orientohej në radhë të parë nga miqësia dhe bashkëpunimi me Bashkimin Sovjetik e vendet e tjera socialiste, nga përkrahja që duhej t'i jepej luftës së popujve kundër imperializmit për të ruajtur e siguruar pavarësinë kombëtare, nga përpjekjet për ruajtjen e paqes dhe për vendosjen e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë.

**Statuti i PPSH** Vija e drejtë politike mund të vihej në jetë vetëm në goftë se zhdukeshin të gjitha shtrembërimet organizative dhe përpunohej një vijë organizative marksiste-leniniste. Rivendosja e normave marksiste-leniniste do ta bënte të plotë kthesën në Parti.

Kongresi vendosi ndërrimin e emrit të Partisë nga «Partia Komuniste e Shqipërisë» në **Partia e Punës e Shqipërisë (PPSH)**. Ky ndryshim ishte i lidhur me përbërjen shoqërore

<sup>1</sup> Rezolucioni i Kongresit I të PKSH. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 567.

të vendit e të Partisë dhe nuk cenonte karakterin dhe qëllimin e saj. Në Shqipëri shumicën e popullsisë, rreth 80 për qind, e përbënte fshatarësia. Kjo pasqyrohej edhe në Parti, ku shumica dërrmuese e anëtarëve të saj ishin punonjës të fshatit. PPSH do të ishte Partia Komuniste në vazhdim.

Normat dhe rregullat e ndërtimit të jetës së brendshme të Partisë u mishëruan në Statutin e Partisë së Punës të Shqipërisë që pranoi Kongresi.

Në pjesën e hyrjes së Statutit u formuluan në vija të përgjithshme qëllimet e Partisë: qëllimi i afërt — ndërtimi i socializmit, qëllimi i fundit — ndërtimi i komunizmit.

① Në Statut theksohej roli udhëheqës i Partisë si në pushtet ashtu edhe në gjithë jetën politike, ekonomike dhe kulturore të vendit.

② Ndërtimi dhe gjithë jeta e brendshme e Partisë mbështetej në centralizmin demokratik. Zbatimi i këtij parimi themelor gjatë Luftës Nacionalçlirimtare ishte i kufizuar për shkak të rrethanave. Pas Çlirimit ai u shkel rëndë nga ndërhyrja e revizionistëve jugosllavë dhe veprimtaria e grupit të Koçi Xoxes. Kongresi porositi që ky parim «të zbatohet dhe të ruhet si drita e syve»<sup>1</sup>.

③ Statuti siguronte unitetin organizativ dhe ideologjik të Partisë dhe e cilësonte atë si kusht të domosdoshëm që ajo të mund të ruante e të forconte bashkimin e masave punonjëse rreth saj e të ishte e aftë të plotësonte qëllimet e veta.

④ Në këtë dokument themeltar për herë të parë u formuluan detyrat e anëtarit të partisë si luftëtar pararojë për ndërtimin socialist të vendit, për forcimin e vazhdueshëm të bashkimit të popullit në Frontin Demokratik dhe për mbrojtjen e RPSH. Në mënyrë të veçantë theksohej detyra e komunistit si «shembull sjelljeje dhe morali», si edhe detyra për të mbajtur e foreuar vazhdimisht lidhjet me masat, për t'u shquar si udhëheqës masash.

⑤ Statuti përcaktonte rregullat e pranimit në Parti në bazë të kushteve shoqërore të vendit në etapën e ndërtimit të bazave të socializmit. Në Parti nuk mund të pranohesh asnjë njeri që shfrytëzonte punën e të tjerëve. Për pranimin e punonjësve

<sup>1</sup> Rezolucioni i Kongresit I të PKSH. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 570.



parashikoheshin kërkesa të shkallëzuara sipas prejardhjes dhe përbërjes shoqërore, duke u dhënë radhën e parë punëtorëve dhe fshatarëve të varfër.

1 — Pranimi i Statutit ishte një ngjarje e madhe për Partinë, e cila për shtatë vjet me radhë e kishte rregulluar jetën e saj të brendshme vetëm mbi bazën e vendimeve, qarkoreve dhe udhëzimeve.

2 — Statuti krijonte një siguri të shëndoshë për të mos lejuar në të ardhmen shkeljen e normave leniniste të jetës së brendshme të Partisë. Kongresi vuri detyrë «të luftohet kundër të gjitha shfaqjeve që kanë për qëllim cenimin e rregullave dhe parimeve organizative të Partisë, të caktuara në Statutin e saj»<sup>1</sup>.

— Për të forcuar punën ideologjike, ai dha orientime e përcaktoi masa konkrete për studimin e marksizëm-leninizmit dhe të historisë së Partisë nëpërmjet formave të edukimit në parti, kurseve e Shkollës së Partisë dhe studimit individual.

Kongresi zgjodhi Komitetin e ri Qendror të Partisë, të përbërë nga 21 anëtarë dhe 10 kandidatë. Në Byronë Politike të KQ u zgjodhën Enver Hoxha, Mehmet Shehu, Hysni Kapo, Gogo Nushi, Spiro Koleka etj. Sekretar i Përgjithshëm u rizgjidh Enver Hoxha.

Kongresi zhvilloi punimet në një nivel të lartë ideologjik, në frymën e një kritike dhe autokritike të shëndoshë. Pjesëmarrja e gjerë dhe e gjallë në rrahjen e problemeve mbi bazën e parimeve të marksizëm-leninizmit ndihmoi në zgjidhjen drejt të çështjeve themelore të politikës dhe të jetës së brendshme të Partisë.

Duke dënuar ndërhyrjen e revizionistëve jugosllavë dhe veprimtarinë trockiste të Koçi Xoxes, Kongresi nuk lejoi, në të njëjtën kohë, të kalohet në anën e kundërt. Ai i cilësoi shumë të dëmshme dhe i dënoi orvatjet që u bënë nga Gjin Marku për t'u dhënë një drejtim krejt të shtrembër punimeve të Kongresit. Duke speculuar me luftën që i shpalli Partia trockizmit dhe revizionizmit, Gjin Marku u mundua të hidhte poshtë gjithë vijën politike të Partisë në të kaluarën, i paditi të gjithë kuadrot kryesorë udhëheqës të Partisë si të prekur nga trockizmi dhe kërkoi të futeshin në një kallëp me Koçi Xoxen e të dënoheshin

<sup>1</sup> Rezolucioni i Kongresit I të PKSH. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 573.

rëndë. Me këtë ai synonte të ndryshonte udhëheqjen e Partisë, të rrëmbente flamurin «e shpëtimtarit» e të dilte në krye të saj. Në këtë mënyrë vepruan edhe disa të tjerë që kishin kryer faje të rënda kundër Partisë për të mbuluar përgjegjësinë e tyre vetjake dhe për të dalë të pafajshëm. Shoku Enver Hoxha me diskutimin e tij i ndihmoi delegatët të zbulonin qëllimin e vërtetë të Gjin Markut e të elementëve të tjerë të sëmurë, të mënjanonin çdo çoroditje dhe të ruanin deri në fund frymën revolucionare e parimore të punimeve të Kongresit.

Kongresi I i PKSH e thelloi më tej dhe e vulosi kthesën që shënoi Plenumi i 11-të i KQ në jetën e brendshme të Partisë e të vendit. Ai e pajisi Partinë me një vijë të përgjithshme të drejtë marksiste-leniniste dhe i armatosi punonjësit me një program shkencor për ndërtimin e bazave të socializmit.

① Kongresi kurorëzoi fitoren e marksizëm-leninizmit mbi oportunizmin e trockizmin dhe armatosi Partinë me një përvojë të madhe të luftës kundër revizionizmit modern.

② Ai forcoi unitetin e Partisë dhe besnikërinë e saj ndaj marksizëm-leninizmit e ndaj internacionalizmit proletar.

Kongresi I parashikoi gjithashtu vështirësitë e mëdha ekonomike e politike që do të haste Partia në plotësimin e detyrave të shtruara. Ai e përgatiti atë t'u bënte ballë pengesave.

Materialet e Kongresit u punuan me gjithë popullin. Masat punonjëse përqaftuan plotësisht vijën e Partisë, kritikuan me guxim gabimet që ishin bërë më parë, shprehën besnikërinë e tyre ndaj Partisë dhe vendosmërinë për të zbatuar programin e saj.

## 2. FORCIMI I LIDHJEVE MIDIS KLASËS PUNËTORE DHE FSHATARËSISË NË LUFTË KUNDËR VËSHTIRËSIVE

Komiteti Qendror i Partisë mori menjëherë një sërë masash të domosdoshme për të vënë në jetë kthesën që shënoi Kongresi. U rishikuan të gjitha ligjet, urdhëresat etj. Në organet lokale të partisë dhe të pushtetit u dërguan nga qendra kuadro me përvojë dhe me autoritet. Bashkimi i këshillave të qytetit e të rrethit i dha fund shkëputjes që ishte krijuar midis fshatit dhe qytetit.

Organizatave bazë të partisë u ndërtuan në bazë prodhimi. Partia i vuri në rrugë të drejtë organizatat e masave. U ndreqën gabimet që ishin bërë lidhur me Frontin dhe u përcaktuan drejt ndërtimi organizativ dhe detyrat e tij që gjetën pasqyrimin e vet në Statutin e ri të Frontit Demokratik të Shqipërisë. Partia goditi me kohë prirjen që u shfaq pas Kongresit të disa komunistë, të cilët mendonin se duhej zhdukur Fronti pasi punën politike me masat e bënin bashkimet profesionale, organizatat e rinisë e të gruas! Fronti Demokratik, si formë organizimi e masave të gjera që ishte bërë traditë e shëndoshë, do të luante edhe në të ardhmen një rol të madh për ruajtjen e forcimit e pandalshëm të unitetit politik të popullit në luftë për ndërtimin socialist dhe për mbrojtjen e atdheut.

Në bazë të orientimit të Kongresit I të PKSH, Kongresi i Unifikimit të Rinisë, që u mbajt në Shkodër në shtator 1949, shkriu Rininë Komuniste dhe Rininë Popullore<sup>1</sup> në një organizatë të vetme që mori emrin **Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë**. Partia i ngarkoi BRPSH si detyrë kryesore të mbanje gjallë dhe të zhvillonte më tej në masat e gjera të rinisë frymën e lartë revolucionare që e kishte karakterizuar atë gjatë luftës dhe në vitet e para pas Çlirimit. Duke qenë në ballë të ndërtimit socialist, rinisë i kërkohesh të kthente sytë nga arsimit, kultura, teknika për të dhënë kuadro të rinj me përgatitje të lartë ideologjike dhe tekniko-profesionale.

Një kujdes më të madh i kushtoi Partia edukimit të klasës punëtore, që po rritej vazhdimisht në valën e industrializimit socialist të vendit, për ta aftësuar atë si klasë udhëheqëse në ndërtimin e shoqërisë socialiste. Kësaj i shërbeu edhe Kongresi II i Bashkimeve Profesionale që u mbajt në tetor 1949.

### **Politika e Partisë për grumbullimin dhe furnizimin**

Problemi më i ngutshëm, që përbënte në këtë kohë hallkën kryesore në vargun e detyrave, ishte forcimi i lidhjeve ekonomike midis klasës punëtore e fshatarësisë dhe ngritja e menjëhershme e forcave prodhuese të bujqësisë. Në një vend si Shqipëria, ku mbizotëronte ekonomia e vogël fshatare, ishte e pamundur të dilej nga prapambetja

<sup>1</sup> «Rini Popullore» u quajt BRASH-i në Kongresin III të tij në tetor 1946.

dhe të ndërtohej socializmi pa përmirësimin e gjendjes në bujqësi, pa zhvillimin dhe përparimin e saj të mëtejshëm. Nuk mund të ngrihej industria pa siguruar furnizimin e saj me lëndë të parë dhe të klasës punëtore me sende ushqimore.

Për t'ia arritur këtij qëllimi duhej, para së gjithash, të zbatohesh një politikë e atillë, e cila të nxiste rritjen e produkteve bujqësore e blegtorale.

Sistemi në fuqi i grumbullimit dhe i furnizimit jo vetëm që nuk mund ta zgjidhte këtë problem, por ishte bërë pengesë për zhvillimin e forcave prodhuese të fshatit. Megjithëse ligji ia njihte të drejtën fshatarit për të shitur lirisht tepricat e produkteve kryesore bujqësore, pasi t'i kishte dorëzuar detyrimet shtetit, në të vërtetë atij i mbeteshin pak ose aspak teprica, sidomos të drithërave. Kjo sillte që ai të mos tregonte interesimin e duhur për shtimin e prodhimit. Veç kësaj, ndikonte për keq edhe sistemi i vjetër i triskëtimit, sipas të cilit, pajiseshin edhe fshatarët me triska për artikuj industrialë. Në këto kushte, fshatari nuk e ndiente veten të detyruar të shpinte në kooperativeve të shitblerjes ato produkte që nuk i nënshtroheshin detyrimit. Për shkak të mungesës së mallrave industriale në tregun e lirë fshatarësia ngurronte gjithashtu t'i dorëzonte detyrimet shtetit. Nga kjo gjendje kishin përfituar kulakët e spekulatorët. Duke siguruar nga shteti sendet e nevojës së parë me anë të triskave, këta zhvillonin me produktet bujqësore e industriale tregun e zi dhe shfrytëzonin masat punonjëse të qytetit e të fshatit.

Lidhjet ekonomike midis fshatit dhe qytetit po dobësoheshin. Punëtori filloi ta shohë fshatarin si spekulator. Organet e pushtetit, nga ana e tyre, për të grumbulluar detyrimet kishin qenë shtrënguar të merrnin shpeshherë masa administrative ndaj fshatarit. Po vihej në rrezik aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë.

Për të mënjeluar këtë rrezik dhe për të forcuar më tej aleancën me fshatarësinë, KQ i Partisë mori një varg masash të rëndësishme ekonomike në ndihmë të fshatit, siç ishin shtimi i kreditit agrar, zgjerimi i bonifikimeve, ndihma me anë të SMT-ve etj. Por këto masa nuk mund të zgjidhnin plotësisht problemin në kushtet kur mbizotëronte prona e vogël private në fshat. Aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë mund të forcohej më tej kryesisht nëpërmjet lidhjeve ekonomike në fuqishën e tregtisë me anë të shkëmbimit të produkteve industriale

me produktet bujqësore. Këto lidhje ishin më të kuptueshme dhe më të leverdishme për fshatarin. Partia e konkretizoi politikën e saj në këtë fushë me vendosjen e **sistemit të ri të grumbullimit e të furnizimit** që u miratua nga Komiteti Qendror në janar 1949.

Sipas sistemit të ri të grumbullimit, sasia që fshatari detyrohej t'i dorëzonte shtetit përcaktohej nga numri i hektarëve dhe kategoria e tokës. Atij nuk i merreshin të gjitha tepricat e produkteve bujqësore e blegtorale, por vetëm një pjesë e tyre, ndërsa pjesën tjetër e përdorte vetë lirisht. Ky sistem nxiste zhvillimin e forcave prodhuese në bujqësi dhe blegtori. Tani fshatari, duke e ditur qysh më parë sasinë e produkteve që detyrohej t'i jepte shtetit, përpiqej të prodhonte sa më shumë për të siguruar teprica sa më të mëdha.

Me anën e sistemit të ri të grumbullimit shteti siguronte një pjesë të mirë të sasisë së drithërave dhe të produkteve bujqësore e blegtorale të nevojshme. Një pjesë tjetër ai e siguronte me anë të sistemit të ri të furnizimit, nëpërmjet të cilit rregullohej shkëmbimi i produkteve industriale me produkte bujqësore e blegtorale dhe furnizimi i punonjësve të qytetit me artikujt e nevojës së parë. Ky sistem mbështetej në organizimin e tri lloj tregjeve. **Tregu i garantuar shtetëror** furnizonte në bazë të triskave punonjësit e qytetit. **Tregu reciprok** furnizonte fshatarësinë nëpërmjet shkëmbimit të tepricave të produkteve bujqësore me mallra industriale. **Tregu i lirë**, ku çmimet ishin shumë më të larta, furnizonte atë kategori njerëzish të papajisur me triska dhe plotësonte kërkesat për mallra që nuk i përfshinte tregu i garantuar e reciprok.

Sistemi i ri i furnizimit bëri diferencimin ndërmjet punonjësve dhe parazitëve, nxiti hedhjen në prodhim të një fuqie punëtore më të madhe si në fshat ashtu edhe në qytet, kurseu një sasi të madhe drithërash që më parë shpërndahej pa rregull dhe shpërdorohej.

Zbatimi i sistemit të ri të grumbullimit e të furnizimit kërkonte të forcohej dhe të gjallërohej tregtia shtetërore e kooperativiste. Në përshtatje me këtë sistem u bë dhe riorganizimi i tregtisë. Format e reja të tregtisë shërbyen drejtpërdrejt edhe për gjallërimin e zgjerimin e industrisë së lehtë.

Për një organizim më të mirë të tregtisë, për shpërndarjen e drejtë dhe të shpejtë të mallrave Partia i kushtoi kujdes të

posaçëm përgatitjes së kuadrit dhe hodhi parullën: «Komunistët të mësojnë të bëjnë tregti».

Një qëndrim i ri u mbajt edhe ndaj tregtisë së vogël private dhe artizanatit privat. Në kushtet kur tregtia dhe industria socialiste nuk ishin në gjendje të plotësonin të gjitha kërkesat e punonjësve, dilte e nevojshme të gjallërohej në një farë shkalle edhe tregu i vogël privat. Kjo bëhej me qëllim që nevojat e punonjësve të plotësoheshin më mirë.

Të lejoje zhvillimin e tregtisë së vogël dhe të artizanatit privat donte të thoshte të lejoje një farë gjallërimi të elementëve kapitalistë. Por çdo rrezik që mund t'i vinte ekonomisë socialiste nga sektori kapitalist mënjanohesh nga kontrolli sistematik që ushtronte shteti mbi të. Veç kësaj, sektori kapitalist nuk kishte ndonjë peshë të shënueshme në ekonominë kombëtare dhe nuk ishte në gjendje të hynte në garë me ekonominë socialiste.

Sistemi i ri i grumbullimit dhe i furnizimit ishte pjesë përbërëse shumë e rëndësishme e politikës ekonomike të Partisë që ndihmonte drejtpërdrejt zhvillimin e gjithë degëve të ekonomisë popullore. Ky sistem zgjidhte drejt çështjen e forcimit të aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë.

### **Në luftë me vështirësitë për zbatimin e sistemit të ri të grumbullimit e të furnizimit**

Zbatimi i sistemit të ri të grumbullimit e të furnizimit hasi në vështirësi të mëdha. Në këtë sistem mishërohej edhe politika e Partisë për kufizimin e elementëve kapitalistë të qytetit dhe të fshatit në dobi të masave punonjëse. Urdhëresat e reja e ngarkonin kulakun me tatime plotësuese dhe i prisnin atij rrugën e spekulimit. Kjo ishte një nga arsyet kryesore që kulakët qysh në fillim u ngritën kundër sistemit të ri të grumbullimit e të furnizimit. Ata u munduan të shtrembëronin përmbajtjen e tij dhe të armiqësonin kështu fshatarësinë me pushtetin popullor, duke përfituar nga fakti që fshatari në fillim nuk e njihnte leverdinë e këtij sistemi dhe propaganda e partisë për këtë çështje ishte ende e dobët. Ata hodhën parulla si «sistemi i ri është i mirë vetëm për punëtorët e nëpunësit», «pushteti e la pa bukë e veshmbathje fshatarësinë, prandaj mos punoni tokat», «fshatarëve të varfër u erdhi koha të vdesin për bukë», «mos dorëzoni bereqetin»! Për të fshehur veprimtarinë e tyre armiqësore, nga një

anë, kulakët vetë plotësonin gjithë detyrimet, nga ana tjetër, shtynin fshatarët e varfër e të mesmë të mos dorëzonin prodhimet. Disa fshatarë, të nxitur nga kulakët, kundërshtuan të mbillnin drithin e planifikuar, duke menduar se në këtë mënyrë do t'i shpëtonin detyrimeve të drithit. Ata nuk e kuptonin se këto detyrime nuk vendoseshin në bazë të sasisë së prodhuar, por të sipërfaqes së tokës së punueshme.

Në fshat pati qëndresë edhe lidhur me zbatimin e urdhëresave të Qeverisë për dorëzimin e detyrimeve të prodhimeve të tjera bujqësore e blegtorale, sidomos të mishit. Në këtë çështje ndikoi për keq edhe fakti që gjatë punimit të Rezolucionit të Kongresit I, disa punonjës partie, duke kritikuar gabimet që ishin bërë në të kaluarën, kishin lënë të kuptohej sikur në të ardhmen nuk do të kishte më detyrime.

Në kurthin e kulakut ranë edhe komunistë. Meqenëse nuk kuptonin rëndësinë e sistemit të ri, perspektivat që çelte ai për zhvillimin e ekonomisë në përgjithësi dhe të bujqësisë në veçanti, ata dyshonin se mos ky sistem ishte në dëm të fshatarëve të varfër. Pati sekretarë organizatash-bazë, komunistë dhe anëtarë këshillash popullorë, që, nën presionin e kulakut, ranë në pozita oportuniste dhe u tërhoqën përpara vështirësive në zbatimin e urdhëresave të grumbullimit. Të tjerë ranë në pesimizëm dhe i drejtoheshin me «qarje» Komitetit Qendror dhe shokut Enver Hoxha, duke shfaqur mendimin se «urdhëresat e Qeverisë për grumbullimin nuk ishin të drejta», se «bujqësia po shkatërrohej», se «fshatari ishte i pakënaqur» etj.

Për të ndryshuar gjendjen e krijuar, një rëndësi të madhe pati letra e hapur e shokut Enver Hoxha «Mbi disa probleme në fshat», botuar në mars të vitit 1949 në «Zërin e popullit». Në këtë letër shpjegohej domosdoshmëria e sistemit të ri dhe theksoheshin sidomos perspektivat që çelte ai për zhvillimin e bujqësisë dhe të gjithë ekonomisë popullore.

Shoku Enver Hoxha tërhoqi vëmendjen e organizatave të partisë në veprimtarinë armiqësore të kulakut. Kulaku nuk ishte në gjendje të përballonte luftën kundër pushtetit popullor me forcat e veta, atij i duheshin aleatë, njerëz që të përqafonin dhe të përhapnin parullat e tij. Prandaj mendohej që pakënaqësinë e vet ta përgjithësonte, ta bënte pakënaqësi të të gjithë fshatarësisë dhe ta ngrinte këtë kundër pushtetit popullor. Në letër u bëhej thirrje komunistëve të qëndronin në krye të luftës për zbatimin e sistemit të ri të grumbullimit e të furnizimit, të

mos epeshin përpara vështirësive dhe me punën e tyre sqaruese të asgjësonin ndikimin e veprimtarisë së armiqve të klasës në radhët e fshatarësisë.

Shoku Enver Hoxha kritikoi ata komunistë, të cilët nuk e kishin të qartë perspektivën e zhvillimit të fshatit në rrugën e përparimit dhe të begatisë, qëndronin skllëvër të mentaliteteve prapanike, duke thënë se «katundari ynë nuk kërkon përveç vajgurin dhe kripën që prodhohen në vend». Ai tregoi karakterin reaksionar të kësaj teze që e largonte fshatarësinë nga synimi dhe përpjekjet për të ngritur mirëqenien e saj, errësonte perspektivat e zhvillimit të bujqësisë dhe të ndërtimit të socializmit në fshat. Ai shpjegoi se «Partia e çon popullin në socializëm, drejt lumturisë dhe begatisë dhe nuk e çon në mesjetë, Partia punon për sot dhe për nesër». Jeta e fshatarit nuk mund të përmirësohet pa ngritjen e fabrikave, uzinave, centraleve elektrike, pa mekanizimin e gjithanshëm të bujqësisë, kurse kjo nuk mund të arrihet në qoftë se bujqësia nuk është në gjendje të furnizojë qytetin me produktet e nevojshme bujqësore dhe industrinë me lëndë të parë.

E keqja, sqaronte shoku Enver, nuk qëndronte në përmbajtjen e urdhëresave të grumbullimit e të furnizimit, por në lidhjet e dobëta të komunistëve me masën fshatare, në mungesën e një pune të gjithanshme sqaruese në fshat.

Letra «Mbi disa probleme në fshat» e shtoi luftën e organizatave-bazë dhe të komiteteve të partisë në rrethe për zbatimin e plotë e të drejtë të vendimit të Komitetit Qendror të Partisë dhe të urdhëresave të Qeverisë mbi sistemin e ri të grumbullimit e të furnizimit.

Ato komitete partie që më parë e quanin në përgjithësi të pamundur plotësimin e detyrave të grumbullimit, pas letrës së shokut Enver u shkundën dhe hoqën dorë nga ky qëndrim. U morën masa të gjithanshme për të bindur fshatarët në drejtësinë e sistemit të ri dhe për të zhvilluar një luftë të organizuar dhe më frytdhënëse kundër armikut të klasës.

Zbatimi i sistemit të ri të grumbullimit e të furnizimit pengohej edhe nga sasia e pamjaftueshme e rezervave të artikujve industrialë që kishte në dorë shteti për t'i shkëmbyer me produkte bujqësore. Gjithashtu shpërndarja e mallrave nuk bëhej në rregull, për arsye të dobësive në ndërmarrjet tregtare.

Këto dobësi e kishin burimin edhe në kujdesin e pakët që tregonin organizatat e partisë për çështjet ekonomike. Pas



Kongresit I vëmendja e tyre u përqendrua në çështjet e brendshme të Partisë, të cilat u shqyrtuan dhe u zgjidhën drejt. Ndërkohë, për zbatimin e detyrave ekonomike u bënë përpjekje të pamjaftueshme. Veç kësaj, organizatat e partisë kishin ende pak përvojë në lëmin e drejtimit të ekonomisë. Prandaj atyre u mungonte iniciativa dhe prisnin që çdo gjë të zgjidhej nga qendra. Shpeshherë çështjet ekonomike shikoheshin ngushtë, vetëm duke u nisur nga plotësimi i nevojave të ditës.

Komiteti Qendror i kritikoi këto qëndrime të gabuara dhe kërkoi nga organizatat e partisë të përqendronin vëmendjen në organizimin e shëndoshë dhe në drejtimin politik të çështjeve ekonomike, të zhdukej mendimi se gjithçka mund të zgjidhej me anën e mitingjeve e manifestimeve. U kritikua gjithashtu pikëpamja e gabuar që filloi të përhapej në disa kuadro të partisë dhe të shtetit se ekonomia mund të çohet përpara duke u mbështetur kryesisht në ndihmën e jashtme.

Në këto kushte, Partisë iu desh të zhvillonte një punë të gjithanshme për të forcuar besimin e kuadrove dhe të punonjësve në forcat e veta, për të rrënjosur në ndërgjegjen e tyre bindjen se faktori vendimtar për ndërtimin e socializmit në Shqipëri ishin burimet dhe forcat e brendshme, ndërsa ndihma e jashtme përbënte një faktor plotësues.

Për të plotësuar kërkesat e punonjësve me artikuj industrialë e bujqësorë Partia mori masa për forcimin e artizanatit të kooperuar. Që të nxitej shtimi i prodhimeve bujqësore e blegtorale, Këshilli i Ministrave caktoi për mbjelljet e vjeshtës së vitit 1949 një kredit të posaçëm dhe zbriti fondin e grumbullimeve të atij viti 15 për qind me anë të ndreqjes së klasifikimit të tokave.

Partia e kishte të qartë se detyrat e mëdha që i dilnin asaj përpara mund të zbatoheshin vetëm duke u mbështetur fuqimisht në masat. Ajo i tregoi hapur popullit gjithë vështirësitë që kalonte dhe do të kalonte vendi dhe i bëri thirrje atij për t'i kapërcyer ato. Në përgjigje të kësaj thirrjeje, me mijëra punonjës të qytetit e të fshatit morën pjesë në brigadat vullnetare për ndërtimin e kombinatit të tekstilit «Stalin», të fabrikës së sheqerit në Maliq dhe të veprave të tjera të planit dyvjeçar. Vendosmëria e popullit për të ndërtuar socializmin u shfaq edhe me rastin e shpalljes së huasë së parë shtetërore, e cila u shndërrua në një aksion të madh politik, ku u shpreh uniteti i popullit me Partinë dhe besnikëria ndaj vijës së saj.

## **Shkatërrimi i planeve të armiqve të jashtëm e të brendshëm**

Vështirësitë e mëdha ekonomike që kalonte vendi pas kthesës historike që shënoi Kongresi I u shfrytëzuan me të gjitha mënyrat nga imperialistët dhe revizionistët jugosllavë. Ata menduan se PPSH nuk do t'i bënte dot ballë gjendjes së rëndë dhe se kishte ardhur çasti më i volitshëm për të zbatuar planet e tyre të errëta ndaj Shqipërisë së rrethuar gjeografikisht nga shtete armike.

Nëpërmjet radios dhe shtypit të SHBA, të Britanisë së Madhe, të Jugosllavisë, të Greqisë etj. shpërtheu një fushatë e shfrenuar shpifjesh e gënjeshtresh kundër RPSH, duke e cilësuar atë si «agresore». Me anë të ajrit dhe me mjete të tjera agjenturat imperialiste dhe jugosllave përhapnin vazhdimisht fletushka, që i bënin thirrje popullit shqiptar të ngrihej kundër Partisë dhe pushtetit popullor.

Krahas veprimtarisë propagandistike, armiqtë e jashtëm grumbulluan e organizuan reaksionarët e arratisur shqiptarë. Imperialistët dhe revizionistët jugosllavë krijuan me ta organizata të reja diversioniste. Qindra të arratisur u dërguan për veprimtari kundërrevolucionare në Shqipëri.

Nga ajri, nga toka dhe nga deti gjatë gjithë kufijve shtetërorë zhvilloheshin provokacione në mënyrë të pandërprerë. E tërë kjo veprimtari kishte për qëllim të përgatiste truallin për sulme të armatosura të drejtpërdrejta kundër RPSH.

Agjenturat amerikane, angleze, italiane, greke dhe jugosllave vepronin kundër Shqipërisë me plane dhe përpjekje të bashkërenduara.

Udhëheqja revizioniste jugosllave vuri në lëvizje agjentët e saj në Shqipëri me anën e përfaqësisë diplomatike në Tiranë. Kjo u bë qendër për organizim diversioni dhe sabotimi ekonomik. Ajo përdori propagandën dhe kërcënimet për të organizuar arratisjen në Jugosllavi të shtetasve shqiptarë.

Qendrat e spiunazhit të huaj krijuan banda diversantësh me elementë reaksionarë e kriminelë të arratisur të ardhur nga jashtë ose që ndodheshin brenda në vend. Këto banda kryen veprime terrori, vranë militantë të partisë e të pushtetit, ndërmjet të cilëve edhe Bardhok Bibën, deputet i Kuvendit Popullor e sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Mir-

ditës. Ato organizuan djegie deposh të kooperativave bujqësore, zyresh të pushtetit dhe shkollash në fshat.

Udhëheqësit titistë ushtruan presion e shantazh të gjithanshëm në fushën diplomatike dhe u përpoqën ta veçonin RPSH. Ata prenë lidhjen ajrore midis saj dhe vendeve të tjera socialiste, prishën në mënyrë të njëanshme Traktatin e Miqësisë, të Bashkëpunimit dhe të Ndhmës Reciproke midis Jugosllavisë e Shqipërisë dhe, më në fund, kërkuan largimin e legatës shqiptare nga Beogradi.

Armiqtë e klasës brenda vendit, duke marrë zemër nga shtimi i veprimtarisë imperialiste e revizioniste, u përpoqën me sa mundën të krijonin një atmosferë frike dhe pasigurie. Ata përhapën parulla si «së shpejti do të ketë luftë», «në gjirin e qeverisë dhe të Komitetit Qendror ka mosmarrëveshje», «gjendja së shpejti do të ndryshojë» etj.

Elementët armiq, duke shfrytëzuar gabimet që ishin bërë në të kaluarën, u munduan të godisnin vijën e Partisë në tërësi, organet dhe kuadrot drejtues të partisë e të pushtetit, duke e nxjerrë veten si «të goditur padrejtësisht» nga reformat e ligjet e shtetit, duke u shtirë sikur «i qanin hallin popullit» dhe sikur «dëshironin të ndreqej çdo e keqe që kishte ndodhur!» Paralajmërimi që bëri Kongresi I për shtrembërimet që mund t'i bënin armiqtë e klasës luftës së drejtë të Partisë kundër gabimeve e të metave për të nxjerrë përfitime për vete nga kjo luftë, ndihmoi të zbuloheshin me kohë taktikat e spekulimet e tyre, të mbroheshin kështu Partia e pushteti, në mënyrë të veçantë organet e Sigurimit.

Në këto rrethana të një lufte shumë të ashpër klasore, më 2 gusht 1949, forca të armatosura greke, të përforcuara me artileri dhe të mbështetura nga aviacioni luftarak, sulmuan në befasi tokën shqiptare dhe u futën në thellësi të saj 300-400 metra. Ky provokacion ishte një akt agresioni dhe qe llogaritur për të vënë në jetë pretendimet shoviniste greke mbi Korçën e Gjirokastrën. Forcat e armatosura të RPSH i bënë ballë agresionit, e thyen dhe e asgjësuan plotësisht armikun.

Në kohën kur ushtria greke shkeli kufijtë e Shqipërisë, e shtoi veprimtarinë e vet armiqësore edhe qeveria jugosllave, e cila ndërmori një lëvizje kërcënuese trupash në kufijtë veriorë të Shqipërisë, në rrethin e Strugës e të Ohrit. Në të njëjtën

kohë agjenturat amerikane, angleze dhe italiane dërguan me anë të ajrit një numër më të madh diversantësh me qëllim që të shkaktonin turbullira në prapavijat e Ushtrisë Popullore. Elementë reaksionarë në vend qenë përgatitur të dilnin në mal. Armatosjen e tyre e kishte marrë përsipër qeveria jugosllave. Këto grupe, të përbëra nga mbeturina të Ballit Kombëtar e të Legalitetit, u asgjësuan para se të shpërthenin «kryengritjen» e tyre.

Të gjitha këto fakte dëshmonin se RPSH ndodhej përpara një veprimtarie agresive të bashkërenduar të monarkofashistëve grekë, të revizionistëve jugosllavë, të neofashistëve italianë, nën udhëheqjen dhe me përkrahjen e imperialistëve amerikanë e anglezë.

Në këto çaste të vështira populli shqiptar u bashkua edhe më fort rreth Partisë. Ai shprehu gatishmërinë e vet për të mbrojtur me çdo kusht fitoret e revolucionit popullor. Mijëra vetë kërkuan të shkonin vullnetarë për të luftuar me armë në dorë kundër agresorëve. Me vendim të KQ të Partisë dhe të Qeverisë u armatosën me dhjetëra mijë fshatarë, të cilët morën pjesë së bashku me forcat e Sigurimit e të Kufirit për asgjësimin e bandave të diversantëve e të kriminelëve. Masat punonjëse e treguan besnikërinë ndaj Partisë dhe pushtetit popullor duke u hedhur me të gjitha forcat për plotësimin e detyrave ekonomike.

Për të forcuar lidhjet e Partisë me masat dhe për të krijuar në popull një besim edhe më të madh te Partia e pushteti popullor, një rol të rëndësishëm luajti vizita e shokut Enver Hoxha në krahinat e Veriut në shtator të vitit 1949 dhe takimet e tij me popullin.

### 3. PËR RUAJTJEN E FORCIMIT E UNITETIT IDEOLOGJIK DHE ORGANIZATIV, PËR PLOTËSIMIN E PLANIT DYVJEÇAR

Lufta kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm të klasës dhe kundër vështirësive u ndërthur me luftën për ruajtjen e forcimin e unitetit ideologjik dhe organizativ të Partisë e me luftën për plotësimin e planeve të prodhimit.

## **Zhdukja e shtrembërimeve dhe e shkeljeve të vijës së Partisë**

Për arsye të kuptimit të gabuar në disa raste të demokracisë së brendshme të partisë pas kthesës dhe si pasojë e presionit të armiqve të brendshëm e të jashtëm të klasës u dukën shkelje e shtrembërime të vijës së Partisë, thyerje të disiplinës, shpërdorime të kritikës e të autokritikës.

Komiteti Qendror i Partisë mori masa të menjëhershme për t'u dhënë fund këtyre shfaqjeve, duke kërkuar zbatimin me rreptësi të Statutit të Partisë.

U shëndosh gjendja e sëmurë që ishte krijuar në organizatën e partisë të rrethit të Lushnjës, ku kishin zënë rrënjë ambicia, mendjemadhësia, karrierizmi, liberalizmi ndaj kulakëve, gjendje që e kishin shfrytëzuar në dobi të tyre armiqtë e klasës. Komiteti i Partisë u shpërnda dhe fajtorët kryesorë u përjashtuan nga organet drejtuese e nga Partia. Kuadro të dërguar nga KQ forcuan udhëheqjen e Partisë në rreth.

Partia dënoi shfaqjet e oportunitizmit që u dukën te disa punonjës të organeve të Drejtësisë, të cilët, duke spekuluar me faktin që organet e Drejtësisë janë institucione të pavarura, e nënvleftësonin kontrollin e Partisë dhe në praktikën e punës së tyre nuk mbanin parasysh që këto organe kanë karakter klasor e nuk mund të veprojnë jashtë luftës së klasave e jashtë udhëheqjes së Partisë.

Në këtë kohë u zbulua grupi antiparti i Abedin Shehut dhe i Niazi Islamit. Tipari dallues i këtij grupi ishte gjunjëzimi përpara presionit të borgjezisë dhe disfatizmi e mosbesimi në vijën ekonomike të Partisë. Planin dyvjeçar ai e quante joreal dhe përhapte frymën e çmobilizimit në kuadrot dhe punëtorët. Puna disfatiste e pjesëtarëve të grupit ndikoi në mosplotësimin e planit në industri, në Naftë e në Transport, ku ata zinin vende drejtuese. Veç kësaj, ata nënvleftësonin historinë e popullit shqiptar, mbanin një qëndrim përbuzës ndaj masave punonjëse dhe veçanërisht ndaj klasës punëtore shqiptare. Nuk kishin besim në aftësinë mbrojtëse të vendit dhe në gatishmërinë luftarake të Ushtrisë Popullore.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH që u mbajt në shkurt të vitit 1950 demaskoi pikëpamjet dhe veprimtarinë e grupit antiparti dhe mori masa të gjithanshme për të zhdukur frymën e disfatizmit që kishte përhapur ky grup.

Vigjilenca e Komitetit Qendror bëri të zbulohet me kohë e të goditej edhe veprimtaria antiparti e Gjin Markut dhe e Nexhip Vinçanit që shtrembëronin politikën dhe minonin udhëheqjen e Partisë në ushtri.

Për t'u prerë rrugën shkeljeve të vijës së Partisë, për të ruajtur dhe për të forcuar unitetin ishte e domosdoshme, veç të tjerave, të çlirohet Partia nga një numër anëtarësh të padenjë. Për këtë qëllim, në janar 1950, Komiteti Qendror i PPSH mori vendimin për vërtetimin e dokumenteve të Partisë.

Vërtetimi i dokumenteve të Partisë ishte një masë organizative e rëndësishme që shërbeu për të pastruar radhët e saj, për të siguruar të dhëna të sakta e të plota për çdo komunist, për të vendosur rregull në qështjet e administrimit në Parti. Në të njëjtën kohë ndihmoi për forcimin e gjithë jetës së brendshme të Partisë dhe u bë një shkollë edukimi për komunistët.

Krahas me këtë, Partia i kushtoi një kujdes shumë të madh përgatitjes ideologjike e politike të anëtarëve të saj, sidomos të atyre që kishin hyrë para kohe në radhët e Partisë, që kishin një nivel të ulët ideopolitik, por që ishin besnikë e të vendosur për të zbatuar vijën e saj. Në të njëjtën kohë Partia mori masa të rëndësishme për të ngritur shkallën e arsimit të komunistëve.

**Konferenca II Kombëtare e Partisë** Kapërcimit të vështirësive që pengonin plotësimin e planit dyvjeçar dhe rritjes së rolit udhëheqës të Partisë u kushtoi punimet e veta Konferenca II Kombëtare e PPSH që u mbajt në prill 1950 në Tiranë.

Konferenca bëri vlerësimin e gjendjes ndërkombëtare e të brendshme të krijuar pas Kongresit I të Partisë.

Raporti i forcave në botë, nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore e këtej, ishte rritur së tepërmi në dobi të socializmit e të çlirimit të popujve dhe në dëm të kapitalizmit e të imperializmit.

Procesi i shndërrimeve revolucionare politike dhe ekonomiko-shoqërore në vendet e demokracisë popullore kishte shkuar duke u thelluar vazhdimisht dhe kishte sjellë si rrjedhim kthimin e tyre në vende socialiste. Qe krijuar kampi i fuqishëm socialist që përfshinte Bashkimin Sovjetik, Shqipërinë, Bullgarinë, Çekoslovakinë, Republikën Demokratike Gjermane,

Hungarinë, Republikën Demokratike të Koresë, Mongolinë, Rumaninë, Republikën Demokratike të Vietnamit.

Në këtë kamp u përfshi edhe Kina pas fitores së revolucionit kinez dhe shpalljes së Republikës Popullore të Kinës më 1 tetor 1949. PPSH, sikurse gjithë lëvizja komuniste ndërkombëtare, e quajti atëherë këtë ngjarje fitoren më të madhe pas asaj të Revolucionit Socialist të Tetorit. Por koha vërtetoi se revolucionit kinez nuk i kapërceu caqet e një revolucionit demokratiko-borgjez dhe se Kina nuk eci në rrugën e zhvillimit socialist.

Megjithëkëtë, fitorja e revolucionit kinez përbënte një fitore të madhe për gjithë forcat antiimperialiste demokratike botërore

Ndërkohë, kapitalizmi botëror, imperializmi me SHBA në krye i shtuan përpjekjet për të shtypur çdo lëvizje revolucionare e nacionalçlirimtare, sidomos për të shkatërruar kampin socialist. Për këtë qëllim kishin krijuar më 1949 bllokun ushtarak agresiv të NATO-s (Pakti i Atlantikut të Veriut). Për këtë shfrytëzuan edhe revizionizmin jugosllav.

Me veprimtarinë agresive e minuese kundër socializmit kishte lidhje drejtpërdrejt edhe sulmi imperialist e revizionist kundër Shqipërisë, për përmbysjen e pushtetit popullor. Armiqtë mendonin se RPSH, meqë nuk kufizohej gjeografikisht me kampin socialist, përbënte pikën më të dobët të këtij kampi. Por populli shqiptar me Partinë në krye ua kishte shkatërruar planin armiqve. «Ka njerëz në botë, — tha shoku Enver Hoxha lidhur me këtë dështim të armiqve, — që bëjnë pyetjen: «Si mundi një popull i vogël, siç është populli shqiptar, i rrethuar nga të katër anët me të tillë ujqër fashistë, që iu vërsulën për ta copëtuar dhe për ta mbytur, të rezistojë heroikisht, të luftojë në të gjitha frontet dhe të triumfojë?» Përgjigjja është e thjeshtë: populli shqiptar rezistoi, luftoi, triumfoi dhe do të triumfojë kurdoherë mbi armiqtë e tij të jashtëm dhe të brendshëm, pse atë e udhëheq Partia e tij e lavdishme...»<sup>1</sup>

Armiqtë kishin dështuar, por ata, theksonte Konferenca, nuk i kishin hedhur armët. Përkundrazi, do t'i shtonin përpjekjet për asgjësimin e socializmit në Shqipëri. Garanci për të

---

<sup>1</sup> Enver Hoxha. Raport në Konferencën II të PPSH. Vepra, vëll. 7, f. 140.

shkatërruar edhe në të ardhmen planet e tyre ishte forcimi i pareshtur i gjendjes së brendshme në çdo pikëpamje, politike, ekonomike, ushtarake, organizative.

Duke analizuar gjendjen e brendshme, Konferenca vuri në dukje se, me gjithë përparimet e arritura, plani i prodhimit për vitin 1949 në industri dhe në mënyrë të veçantë në nxjerrjen e naftës nuk ishte plotësuar. Kjo kishte rrjedhur për disa shkaqe. Specialistët jugosllavë para se të largoheshin kishin zhgazifikuar fushat e vajgurit. Për keq kishte ndikuar veprimtaria disfatiste e grupit antiparti. Një shkak tjetër përbënin dobësitë në drejtimin e industrisë dhe mungesa e fuqisë punëtore.

Nuk ishin plotësuar detyrat as në bujqësi.

Me qëllim që të përballohej gjendja e krijuar dhe të plotësohej plani dyvjeçar, Konferenca dha orientimin për të tejkaluar planin e vitit 1950 në të gjitha degët në mënyrë që të mbuloheshin deficitet e vitit 1949 atje ku kishte mundësi.

Në fushën e bujqësisë Konferenca i vuri Partisë detyrë kryesore të zhvillonte me durim një punë të madhe politike sqaruese dhe organizuese për të bindur fshatarin të mbilte ato kultura për të cilat kishte nevojë ekonomia kombëtare dhe që përfshiheshin në planin e shtetit.

Njëkohësisht ajo tërhoqi vëmendjen që të mos lihej pas dore edhe çështja e kolektivizimit, ndonëse nuk duhej shpejtuar. Ajo kërkoi të tregohet kujdes i veçantë «për forcimin e kooperativave bujqësore në mënyrë që këto të bëhen shembull dhe nxitje për ngritjen e kooperativave të reja në zonat tona fushore»<sup>1</sup>.

Që të rritej roli udhëheqës i Partisë, Konferenca udhëzonte të përmirësohej metoda e punës dhe udhëheqja kolegjiale, të luftohej kundër burokratizmit e të tregohet një kujdes më i madh për drejtimin politik të çështjeve ekonomike dhe shtetërore. Duke kritikuar rastet kur organizatat e partisë zëvendësonin organet shtetërore dhe ekonomike, ajo kërkoi që udhëheqja e Partisë të realizohej jo me anën e një zëvendësimi të tillë, por nëpërmjet një veprimtarie të shëndoshë politike dhe një ndihme e kontrolli të vazhdueshëm me frymë partie.

---

<sup>1</sup> Rezolucioni i Konferencës II Kombëtare, 14 prill 1950. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. II, f. 156.



Konferenca kritikoi qëndrimet e veçanta mospërfillëse ndaj organizatave të masave, sjelljet arrogante të disa komunistëve me qytetarët. Ajo theksoi nevojën e një pune të vazhdueshme për forcimin e lidhjeve të Partisë me masat, për një gjallëri më të madhe në organizatat shoqërore dhe në këshillat popullore, që të rritej pjesëmarrja e punonjësve të qytetit e të fshatit në zgjidhjen e problemeve të qeverisjes e të ekonomisë.

### **Plotësimi i planit dyvjeçar 1949-1950. Forcimi i gjendjes së brendshme**

Vendimet e Konferencës II Kombëtare ndihmuan për ndreqjen e shumë të metave në punën e Partisë

së dhe për një mobilizim më të madh të komunistëve e të gjithë punonjësve në zbatimin e planit dyvjeçar.

Si rrjedhim, plani i prodhimit industrial për vitin 1950 u tejkalua. Por deficitet e vitit 1949 nuk u mbuluan krejt. Kështu plani dyvjeçar u plotësua vetëm 91 për qind. Prapëseprapë ritmi mesatar vjetor i rritjes prej 10,5 për qind ishte një sukses i madh për kushtet e vështirësive të jashtëzakonshme. Më 1950 prodhimi industrial qe shtuar katër herë në krahasim me vitin 1938.

Ndërkaq, prodhimi bujqësor gjatë dyvjeçarit 1949-1950 qe rritur me një ritëm shumë të vogël, përkatësisht 2 dhe 2,2 për qind. Kjo shpjegohej kryesisht me copëtimin e madh të tokës, ku mbisundonte ekonomia e vogël individuale (në vitin 1950 kishte vetëm 90 kooperativa bujqësore përballë 145 000 ekonomive individuale). Megjithatë, zbatimi i sistemit të ri të grumbullimit, i shoqëruar me një punë të gjerë politike sqaruese të Partisë me masat e fshatarësisë punonjëse, solli sigurimin e pjesës më të madhe të fondit shtetëror të drithërave e të produkteve të tjera bujqësore.

Këto arritje në fushën e prodhimit e të grumbullimeve çuan në përmirësimin e jetesës së masave punonjëse. Në vitin 1950 u bë një ulje e rëndësishme e çmimeve të mallrave në tregun shtetëror.

Në luftën e ashpër kundër vështirësive dhe kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm për plotësimin e detyrave politike, ekonomike, kulturore, ushtarake etj. u forcua aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe uniteti Parti-popull. Kjo u shpreh qartë në zgjedhjet e majit 1950 për Kuvendin Popullor, ku morën

pjesë në votime mbi 99 për qind e votuesve dhe votuan për kandidatët e Frontit Demokratik, d.m.th. për vijën revolucionare të Partisë, më se 98 për qind e tyre.

Në korrik të vitit 1950 Kuvendi Popullor vendosi të bëheshin disa shtesa dhe ndryshime në Kushtetutën e Republikës Popullore të Shqipërisë. Këto kishin lidhje me shndërrimet ekonomiko-shoqërore të kryera në Shqipëri në periudhën katërvjeçare që nga pranimiti i Kushtetutës. Në Kushtetutë u shtua neni: «Republika Popullore e Shqipërisë është një shtet i punëtorëve dhe i fshatarëve punonjës». U shtua edhe një nen, me anën e të cilit njihej roli udhëheqës i Partisë në të gjithë jetën e vendit.

Ndërkohë, Partia i kishte qëndruar besnike politikës së saj të jashtme revolucionare. Në korrik 1950, Kuvendi Popullor mori vendimin për t'u bashkuar me thirrjen e Stokholmit mbi përkrahjen e lëvizjes së paqes në botë. Në të njëjtën kohë, bëri deklaratën kundër ndërhyrjes së armatosur të imperialistëve amerikanë në Kore. Në janar 1951 ai nxori ligjin që dënonte nxitjen dhe propagandën për luftë agresive, duke i cilësuar këto si «krime të rënda kundër njerëzimit, paqes midis popujve dhe atdheut».

### **Kundër shfaqjeve të pajtimit me armikun e klasës**

Ndërkohë, imperialistët amerikanë dhe anglezë me veglat e tyre, qarqet sunduese reaksionare të Italisë e të Greqisë dhe revizionistët jugosllavë, vazhduan me tërbim veprimtarinë armiqësore kundër RPSH. CIA amerikane kishte përpunuar një plan të posaçëm për të përmbysur pushtetin popullor në Shqipëri e për ta shkëputur atë nga «blloku komunist». Për këtë qëllim, armiqtë e jashtëm dëndësuan propagandën e tyre armiqësore, provokacionet kufitare, dërgimin e bandave të diversantëve, sidomos të agjentëve të spiunazhit. Diversantët kryen një varg tjetër aktesh terrori, sabotimesh dhe plaçkitjesh të ekonomisë shtetërore e kooperativiste. Në mënyrë të veçantë armiqtë përdorën taktikën e presionit të drejtpërdrejtë mbi komunistët, sidomos mbi komunistët e fshatit. Disave u dërgonin letra kërcënuese, të tjerëve u çonin befasisht në shtëpi diversantë. U dërgonin komiteteve të partisë ankesa të shumta provokuese për njërin e tjetrin komunist, për njërin e tjetrën masë të rëndë që ishte marrë «padrejtësisht» dhe që duhej të hiqej. Shtynin anëtarë

partie të ndryshëm të shkelnin moralin komunist, të shpërdoronin e të vidhnin pasurinë socialiste. Kulakët përpiqeshin të lidheshin me komunistë nëpërmjet martesave, «ndihmave» materiale etj.

Përballë këtij presioni një numër komunistësh u lëkundën, disa edhe u gjunjzuan. Si pasojë, u dukën shfaqje butësie, zemërgjerësie e lëshimesh ndaj kulakëve dhe armiqve të tjerë të klasës, u vu re te disa një farë prirjeje pajtimi me ta.

Përpara presionit të armiqve të klasës u gjunjzuan edhe disa anëtarë të Komitetit Qendror, midis tyre Tuk Jakova, anëtar i Byrosë Politike e sekretar i KQ për çështjet organizative. Ky gjunjzim i tij nuk qe i rastit. Veprimtaria e tij si komunist ka qenë përshkuar kurdoherë prej një oportunizmi të thellë, prej mungesës së vigjilencës revolucionare, moskokëçarjes në kryerjen e detyrave dhe në ngritjen ideologjike.

Në Kongresin I të PKSË ai përfitoi nga rasti i dënimit të veprimtarisë armiqësore të Koçi Xoxes për t'u paraqitur si njëri ndër komunistët më të persekutuar prej tij dhe për të mbuluar përkohësisht qëndrimet e veta të kundërta me vijën e Partisë.

Pas Kongresit Tuk Jakova, si edhe më përpara, u thye nga presioni i borgjezisë dhe e dëmtoi rëndë veprimtarinë e Partisë me qëndrimet e veta oportuniste ndaj armikut të klasës. Për të, lufta e klasave po shkonte drejt shuarjes, RP të Shqipërisë nuk i kanosej ndonjë rrezik nga imperialistët amerikanë dhe revizionistët jugosllavë. Ai nxiste me mënyra të ndryshme zbatimin e një politike të butë ndaj kulakëve. Ndërhynte pranë organeve shtetërore për t'u bërë lehtësira elementëve armiq, për t'i liruar ata nga burgu, e nënvleftësonte krejt veprimtarinë armiqësore të klerit reaksionar katolik dhe e përkrahte atë me gjithfarë mënyrash.

Tuk Jakova ishte në kundërshtim me vijën ekonomike të Partisë që i jepte përparësi zhvillimit të industrisë së rëndë dhe në mënyrë të veçantë zhvillimit të industrisë minere. Shprehej sidomos kundër investimeve në industrinë e naftës. Ai ushqente idenë se plani ekonomik në disa degë nuk ishte real. Me një qëndrim të tillë oportunist e disfatist ai kishte penguar punën e organizatave të partisë dhe të masave për plotësimin e planit të shtetit.

Gabime të palejueshme Tuk Jakova kishte bërë edhe në çështjet organizative të partisë. Moskokëçarja dhe lëshimet në

zbatimin e Statutit e të vendimeve të Partisë, drejtimi nga ana e tij në mënyrë burokratike kishin sjellë të meta serioze në zbatimin e politikës së kuadrit, në metodën e punës së organeve e të aparateve të partisë e të organizatave të masave. Kjo kishte shkaktuar gjithashtu thyerje të rregullave të pranimit në Parti, shkelje të disiplinës, dobësim të kritikës e të vigjilencës.

Ai kishte qenë përkrahës i idesë së gabuar, sipas së cilës vërtetimi i dokumenteve të Partisë duhej të bëhej jashtë kontrollit të masës së komunistëve, pa pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të organizatave-bazë.

Plenumi i 9-të i Komitetit Qendror, që u mbajt në shkurt 1951, duke analizuar gjendjen politike dhe punën e Partisë, zbuloi shkaqet e shfaqjeve oportuniste ndaj armikut të klasës dhe tregoi rrugët e luftës kundër tyre. Ai dënoi qëndrimet antimarksiste e gabimet e rënda të Tuk Jakovës, e shkarkoi atë nga përgjegjësia si sekretar i KQ dhe e përjashtoi nga Byroja Politike.

Me këtë rast Komiteti Qendror i bëri një kritikë të shëndoshë marksiste-leniniste punës së vet dhe ndreqi menjëherë të metat që kishte lejuar nën ndikimin e qëndrimeve mospërfillëse dhe oportuniste të Tuk Jakovës. U morën masa për të përmirësuar udhëheqjen kolegjiale, për të forcuar kritikën dhe autokritikën, për të kërkuar më tepër llogari nga anëtarët e Plenumit, për të ushtruar një kontroll më sistematik dhe më të rreptë në zbatimin e vendimeve.

Partia u mobilizua me një forcë të re për t'i prerë rrugën çdo prirjeje dhe shfaqjeje të pajtimit me armikun e klasës. Organizatat e partisë u vunë në pozita më luftarake. Analiza marksiste-leniniste që i bëri Komiteti Qendror gjendjes politike dhe punës së partisë, qëndrimi i rreptë parimor ndaj oportunitizmit i ndihmoi komunistët të kuptonin më thellë e më konkretisht domosdoshmërinë objektive të luftës kundër armiqve të klasës, të ruheshin më mirë nga shkarja në pozita pajtimi me ta.

Në mënyrë të veçantë u përqendrua vëmendja në zbatimin e drejtë të politikës së Partisë për kufizimin ekonomik dhe veçimin politik të kulakëve, duke tërhequr në luftë kundër tyre në një shkallë më të gjerë fshatarët e varfër e të mesmë. Për këtë ndihmoi masa e posaçme e vërtetimit me saktësi të të gjithë kulakëve. Kulakët u përjashtuan prej të gjitha ndihmave

që gëzonte fshatarësia nga shteti. Ata u rënduan me tatime financiare edhe më të mëdha. Kur kulakëve u konfiskohej pasuria, u vendos që 25 për qind e saj t'u shpërndahej falas fshatarëve të varfër.

Duke luftuar kundër pajtimit me armikun e klasës, Partia goditi njëkohësisht të gjitha shfaqjet sektare që shkaktonin paqartësi politike në masat dhe pengonin mobilizimin e tyre në plotësimin e detyrave politike dhe ekonomike, tërheqjen e tyre në luftë të gjallë kundër armiqve. U kritikuan rëndë ato komitete partie që shtrembëronin në praktikë politikën e Partisë dhe lejonin të merreshin masa administrative të parakohshme për zhdukjen e menjëhershme të kulakëve, si klasë, dhe, aq më keq, të futeshin në kategorinë e kulakëve edhe fshatarë të mesmë. Partia ishte kundër çdo mase që çonte në ashpërsimin artificial të luftës së klasave, sepse nga masa të tilla nxirrnin përfitime vetëm armiqtë.

Në luftë për kapërcimin e vështirësive, kundër imperialistëve dhe revizionistëve jugosllavë, kundër armikut të brendshëm të klasës, kundër oportunitizmit, Partia e ruajti dhe e forcoi unitetin e vet ideologjik dhe organizativ, e pasuroi përvojën e udhëheqjes politike në ndërtimin socialist të vendit.

### **Përpjekjet për ta nxjerrë bujqësinë nga prapambetja**

Një nga problemet më shqetësuese për Partinë vazhdon të ishte prapambetja e bujqësisë. Masat që ishin marrë në vitet 1949-1950, me gjithë ndikimin e tyre për të mirë, nuk i jepnin rrugëzgjidhje problemit. Bujqësia vazhdoi të zhvillohej me ritme të ngadalshme, shpërpjesëtimi midis zhvillimit të bujqësisë e të industrisë po thellohej. Kjo gjendje kishte shkaktuar vështirësi në plotësimin e kërkesave të masave punonjëse me prodhime bujqësore dhe në furnizimin e industrisë me lëndë të parë.

Problemi i nxjerrjes së bujqësisë nga prapambetja u mor në shqyrtim në Plenumin e KQ të PPSH të prillit 1951. Mirëpo në këtë Plenum problemi u trajtua në mënyrë të njëanshme dhe u arrit në përfundimin jo të drejtë se ekonomia e vogël fshatare i kishte shteruar të gjitha mundësitë e rritjes së prodhimit bujqësor. Duke u nisur nga vlerësimi i drejtë se kooperimi ishte mjeti kryesor për ta nxjerrë bujqësinë nga prapambetja, Plenumi vendosi të kalohej në kolektivizimin në masë të bujqësisë. Por ky ishte një vendim i parakohshëm dhe për-

mbante në vetëvete rrezikun e komprometimit të kolektivizimit, sepse ende nuk qenë krijuar kushtet për riorganizimin socialist të gjithë bujqësisë. Partia e ndreqi me kohë këtë vendim të shpejtuar. Në maj u mbledh përsëri Plenumi i Komitetit Qendror. Ai theksoi se për kushtet konkrete detyrë kryesore nuk ishte zgjerimi i kolektivizimit në fshat, por forcimi i kooperativave bujqësore të ngritura dhe shfrytëzimi i të gjitha mundësive të ekonomisë së vogël fshatare për të rritur prodhimin.

Partia, duke vlerësuar drejt të gjitha kushtet, mundësitë dhe mjetet, arriti në përfundimin se për ta çuar bujqësinë përpara rruga më e mirë për atë kohë ishte forcimi dhe përsosja e mëtejshme e lidhjeve ekonomike midis qytetit dhe fshatit, rregullimi i shpërpjesëtimeve midis industrisë dhe bujqësisë.

Gjatë vitit 1951 u shtua ndihma për fshatin. U morën masa për ndreqjen e gabimeve që ishin bërë në kadastër dhe në klasifikimin e tokave. Detyrimi i drithërave u ul mesatarisht 25 për qind dhe u përjashtuan nga tatimi ekonomitë bujqësore individuale që kishin të ardhura vjetore të pakta.

Duke qenë se përpjesëtimi i çmimeve të mallrave industriale e bujqësore ishte i tillë që nuk e nxiste fshatarësinë për të shtuar prodhimet dhe për ta tërhequr tërësisht në tregun reciprok, KQ i Partisë mori vendim të ulëshin çmimet e mallrave industriale. Zbritja e re e çmimeve të këtyre mallrave në vitin 1951 e zvogëloi deri në një farë mase shpërpjesëtimin në çmime.

Në të njëjtën kohë u punua për forcimin e kooperativave të shitblerjes, për t'i bërë ato organizata të fuqishme masash që ndihmonin për lidhjen ekonomikisht dhe politikisht të fshatit me qytetin.

Masat ekonomike për ta nxjerrë bujqësinë nga prapambetja u shoqëruan me një punë të gjerë politike dhe organizative të Partisë.

#### 4. KONGRESI II I PPSH. DETYRAT PËR SHNDËRRIMIN E SHQIPËRISË NË NJË VEND BUJQËSOR-INDUSTRIAL

Kongresi II i PPSH zhvilloi punimet nga 31 marsi deri më 7 prill 1952. Në kongres morën pjesë 592 delegatë me votë deliberative dhe 142 me votë konsultative, që përfaqësonin 44 418 anëtarë dhe kandidatë partie. Efektivi i Partisë në këtë